

**LIGJ**  
**Nr. 100/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 193, DATË 3.12.2009 "PËR  
MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË  
ÇËSHTJET PENALE"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të  
Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 5 pika 3, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:  
"Përkthimi kryhet nga Ministria e Drejtësisë."

Neni 2

Në nenin 33 pika 2, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:  
"Aktet plotësuese të paraqitura nga shteti kërkues i përcillen organit të prokurorisë, të përkthyer, brenda 7 ditëve nga marrja e tyre."

Neni 3

Në nenin 72 pika 3, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:  
"Aktet plotësuese të paraqitura nga shteti kërkues i përcillen organit të prokurorisë, të përkthyer, brenda 7 ditëve nga marrja e tyre."

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.3.2013

Shpallur me dekretin nr. 8071, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani